



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 33
Prishtinë, më 21 shtator 2016, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla S-II-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Faton Topalli, Ali Sadriu, Naim Fetahu, Hajdar Beqa, Abdyl Ymeri, Fikrim Damka, Bali Muharremaj, Synavere Rysha dhe Enver Hoti.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj, koordinatorë e Komisionit; Mehmet Simnica, zyrtar i fushës për ekonomi dhe Mentor Hyseni, ekspert nga GIZ- i.

Pjesëmarrësit tjerë në takim: Qendresa Mulaj, Bujar Bajraktari, Valon Bytyçi, Vlora Mehmeti. Besnik Osmani dhe Artan Venhari- ZKA, Redi Ahmetllari dhe Fatos Cocolli- Kontrolli i Lartë i Shtetit të Shqipërisë, Kujtim Shala, Faton Peci, Veton Firzi dhe Feim Hoxha- MKRS, Ljubomir Mariq, Rozafa Ukimeraj, Besim Kamberaj dhe Avni Sahiti- MAPL, Shefki Kastrati dhe Fjolla Uka nga NDI.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 13.7.2016;
3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015;
4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015;
5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015;
6. Shqyrtimi i Raportit të Performancës së Auditorit të Përgjithshëm dhe pasqyrave financiare të audituara për vitin 2015;
7. Të Ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetari, konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 13.7.2016;

Kryetari, konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 13.7.2016, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar, me 31 dhjetor 2015;

Faton Topalli, kryetar, njoftoi deputetët se në takim sot nuk ka ardhur askush nga Ministria e Drejtësisë, edhe përkundër komunikimit që stafi ka pasur me zyrtarët e kësaj Ministrie dhe mbetet që ky raport të shqyrtohet në mbledhjen e radhës së KMFP-së dhe për këtë mori aprovimin nga të gjithë deputetët e pranishëm në takim.

Përfundim

KMFP, vendosi që Ministrinë e Drejtësisë ta ftojë për të raportuar në ndonjë nga mbledhjet e radhës së Komisionit, për ta shqyrtuar Raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Drejtësisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015.

4. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015;

Faton Topalli, kryetar- Për ta diskutuar Raportin e Auditimit për PVF e MKRS-së, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, ne kemi ftuar Ministrinë e MKRS-së, z.Kujtim Shala. Ministër është hera e tretë që komisioni Ju ka ftuar për ta shqyrtuar këtë raport, por në mungesë tuajën nuk kemi arritur ta diskutojmë. Unë si referues i këtij raporti, do ta bëjë një përmbledhje të të gjeturave që janë në këtë raport dhe pastaj do të shtrohen pyetje edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit dhe në fund do ta keni rastin ju ti jepni sqarimet tuaja.

Opinionin e Auditimit me theksim të çështjes për MKRS-në, është se Ministria nuk e dinë vlerën e pasurisë financiare në Ministri. Po e nisi me përdorimin e subvencioneve, ku me vite radhazi janë ndarë mjete për subvencione dhe për to nuk ka arsyetim, për çka janë ndarë ato subvencione, pastaj kemi keqpërdorim të buxhetit, ku 249.313 euro për mallra dhe shërbime janë shfrytëzuar nga subvencionet, pastaj nga mallrat dhe shërbimet 52.232 euro janë paguar, për subvencione dhe transfere dhe 7.137 euro për paga dhe mëditje, pastaj 69.679 euro për paga dhe mëditje janë shfrytëzuar për mallra dhe shërbime, pra kemi kështu një kaos në kuptim të shpërndarjes dhe shfrytëzimit të buxhetit, pra, ka një keqmenaxhim dhe planifikim të buxhetit. Problematikë tjetër është se në vitin 2014, kemi 24 rekomandime të auditorit të jashtëm, ku nga to vetëm 5 janë implementuar, 5 janë adresuar për implementim, ndërsa 14 të tjera nuk janë

adresuar fare. Pastaj, keni problem me auditim të brendshëm. Janë planifikuar 5 auditime dhe janë kryer vetëm 2, keni dobësi në prokurim, ku për palestrën sportive në Istog janë dhënë 84.759 €, pa përfunduar projekti, kemi kompensime të stafit për punë jashtë orarit. Janë 30 raste që janë bërë pa aprovim të mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë dhe nuk janë dokumentuar me asgjë që e arsyeton që kanë kryer punë jashtë orarit.

Punësimet e parregullta, janë bërë 100 punësime nga viti 2014. Vetëm në vitin 2015, janë 38 punësime edhe përkundër vërejtjeve që i ka dhënë auditori në vitin 2014, 21 nga ta paguhen nga pagat dhe mëditjet, ndërsa 79 të tjerë paguhen nga subvencionet. Në 10 raste kemi vlerën prej 9.600 €, ku paguhen nga subvencionet, zyrtarët, paguhen si mbikëqyrës të projekteve apo si anëtarë të këshillave drejtues pa asnjë bazë ligjore. Ka edhe çështje të tjera, ku janë paguar 7 mijë euro për dy koncerte dhe është mbajtur vetëm një koncert. Ka edhe të tjera, por besoj që ato do t'i shtrojnë anëtarët e tjerë të Komisionit.

Abdyl Ymeri - Bazuar në të dhënat e paraqitura në raport nuk mendoj se këtu kemi keqpërdorim të mjeteve, por këtu bëhet fjalë për keqmenaxhim të mjeteve. Po ashtu, dëshiroj të di se si qëndron situata me punën e auditorit të brendshëm. Pse nuk ka arritur ta përmbushë planin e auditimit? Ku qëndron problemi? Pse është ky numër kaq i madh i të punësuarve me kontratë mbi vepër? A nuk ka ekspertë brenda MKRS-së?

Kemi rastet e palestrave të nisura, të cilat ende nuk janë përfunduar, si në Skenderaj, Istog etj?

Synavere Rysha, tha se raporti i Auditimit për MKRS-në, duhet vlerësuar lartë, mendoj se raporti ka të dhënat të cilat janë të studiuara mirë dhe të analizuara në aspektin profesional.

Enver Hoti - Një çështje që kërkon vëmendje është se një numër i rekomandimeve nuk janë zbatuar nga raporti i Auditimit për vitin e kaluar, e 14 prej tyre nuk janë adresuar fare. Po ashtu realizimi i buxhetit nuk është në harmoni të plotë me planin e rrjedhës së parasë, pra shpenzim më i madh në tremujorin e fundit të vitit. Pse kemi projekte të cilat kanë filluar që nga viti 2009 dhe nuk janë përfunduar ende. Mendoj se kjo është përgjegjësi e Ministrit të MKRS-së.

Hajdar Beqa- Është e vërtetë se një numër i rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit për MKRS janë rekomandime të cilat janë të njëjta në shumicën e organizatave buxhetore.

Pse nuk kemi zbatim të rekomandimeve të dhëna në Raportin e Auditimit për vitin paraprak? Po ashtu kemi një numër të pagesave për punëtorët, të cilët janë paguar si punëtorë me kontratë në vepër, më gjatë se 6 muaj, si mendoni ta adresoni këtë çështje? Pse ka shmangieje nga rregulloret dhe ligjet, nga ana e MKRS-së?

Pasi nuk pati pyetje të tjera nga deputetët, fjala ju dha ministrit të MKRS-së.

Kujtim Shala, ministër i MKRS-së, paraqiti qëndrimet dhe opinionin e MKRS lidhur me Raportin e Auditimit për PVF të Ministrisë, të gjeturat në raport dhe masat e ndërmarra nga ministri dhe stafi i tij për adresimin e rekomandimeve. Ministri shtoi se të gjithë hapat janë paraqitur në planin veprimit për adresim të rekomandimeve nga ana e MKRS-së.

Pasi nuk pati diskutim tjetër në këtë pikë, u nxor ky përfundim.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që Raporti i Auditimit për Ministrinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, të mos adresohet për seancë plenare. Megjithatë, obligohet MKRS-ja të zbatojë në përpikëri planin e veprimit për adresim të rekomandimeve të dorëzuar paraprakisht në KMFP dhe në ZAK.

5. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015;

Kryetari- Nga gjithsejtë, 10 rekomandime të dhëna në Raportin e Auditimit të vitit 2014, MAPL ka implementuar 7 dhe ka adresuar 3. ndërsa, në 2 fusha sa i përket ndarjes së subvencioneve dhe avancave dhe shpenzimeve tjera, nuk ka pasur rekomandime. Lista e vetëvlerësimit (e implementuar), Lista e rreziqeve (e implementuar), Pagesa e Komitetit të Auditimit (e implementuar). Mbi vlerësimi i pasurisë, projektet e financuara për komuna dhe mosregjistrimi i tyre në asete të Komunës, mosinventarizimi me kohë i pasurisë etj. Me këtë hapi diskutimin.

Ljubomir Mariq-MAPL- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, bazuar në rekomandimet e raportit vjetor për vitin 2015, që nga fillimi i vitit 2016 e deri më tani ka implementuar dhe ka adresuar të gjitha rekomandimet nga ky raport. Lista e rreziqeve, MAPL, ka hartuar listën e vetëvlerësimit dhe listën e rreziqeve, ashtu siç është evidentuar nga raporti. Hartimi i listës së rreziqeve të mundshme dhe listës kontrolluese të vetëvlerësimit, shqyrtimi i listës së rreziqeve dhe listës kontrolluese për të vërtetuar saktësinë e listës. Caktimi i një personi përgjegjës (koordinatori) për të monitoruar listën e vetëvlerësimit dhe ofrimit të dokumenteve të dokumenteve përcjellëse. Përgatitja e raporteve tremujore, mbledhje të rregullta të menaxhmentit të lartë për të monitoruar dhe rishikuar listën e vetëvlerësimit. Avancimi i kontrollit të brendshëm – qeverisja dhe kontrolli.

Sa i përket shqyrtimit të kontrolleve të menaxhmentit, MAPL-ja ka forcuar akoma më shumë sistemin e kontrollit dhe ka rritur cilësinë e mbikëqyrjes përmes veprimeve në vijim: Takime të menaxhmentit me Komitetin e Auditimit, plane të integruara për të adresuar rekomandimet e auditimit të jashtëm dhe të brendshëm, krijimi i sistemit të monitorimit për zbatimin e planit të integruar, raporte periodike për zbatimin e rekomandimeve të auditorit të brendshëm dhe të jashtëm (raporte tremujore), analizë e përmbushjes së rekomandimeve (raporte tremujore), analizë e implementimit të planit të punës (raporte tremujore), raporte mbi aktivitetet e Ministrisë (raporte tremujore), raporte javore të departamenteve (raporte individuale për secilin dhe çdo anëtarë të stafit të ministrisë), takimet javore të menaxhmentit (sekretarë dhe drejtorë); procesverbali i takimeve (takimet javore të stafit të të gjitha departamenteve (procesverbali i takimeve), raporte javore për zbatimin e projekteve të infrastrukturës publike në komuna, raporte ditore dhe javore mbi ekzekutimin e buxhetit, krijimi i një regjistri të zotimeve dhe azhurnimi i të dhënave në baza javore, hartimi i udhëzimeve të brendshme mbi ciklin e pagesave për të gjitha kategoritë buxhetore (investimet publike, mallrat dhe shërbimet si dhe udhëzimet për buxhetin.

Rozafa Ukimeraj, MAPL, theksoi se **Prokurimi** në MAPL (që nga korriku 2016, menjëherë pas publikimit të raportit të fundit të auditimit), ka filluar t'i zbatojë rekomandimet e auditimit (siç kërkohet në nenin 22 të Ligjit për Prokurimin Publik), si dhe të përdorë një dokument udhëzues dhe listë kontrolluese për fillimin e prokurimit nga zyrtari autorizues për të gjitha

procedurat e prokurimit. MAPL-ja konfirmon deklaratën e disponueshmërisë së fondeve para nënshkrimit dhe publikimit të dhënies së kontratës. MAPL-ja kujdeset që deklarata e disponueshmërisë së fondeve të jetë në përputhje me planin e prokurimit, përveç për aktivitetet e paplanifikuara, të cilat i dorëzohen AQP-së për miratim.

MAPL-ja themelon Komisionin për hartimin e specifikimeve teknike për procedurat e tenderimit për çdo procedurë të iniciuar të prokurimit. MAPL-ja ka përgatitur një udhëzues të brendshëm për procesin e tenderimit (duke filluar nga referimi fillestar deri në procedurat për nënshkrim të kontratës).

Aktualisht, MAPL-ja zbaton kontratën e AQP-së sa i përket shërbimit të biletave të fluturimit.

Realizimi i buxhetit-Sa i përket realizimit të buxhetit sipas kategorive buxhetore, realizimi i buxhetit është si vijon: Investime kapitale: MAPL ka arritur që të zotojë 99.46 % të investimeve kapitale; 2,020,000€ për projektet të të gjitha komunave që është zotuar 100% dhe shpenzimi arrin vlerën 92.90%. Mirëpo, duke marrë në konsideratë procesin e integritetit dhe funksionalizimit të katër komunave, si një ndër prioritetet kryesore qeveritare Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, që kanë financuar projektet në vlerë 1 mil €, si pjesë e participimit për financim në kuadër të këtij procesi.

Ndarja e këtyre projekteve ka kërkuar një koordinim ndërministrorë si dhe konsultim me partnerët ndërkombëtarë për shkak të koordinimit ndërinstitucional dhe çështjeve të karakterit politik, procesi i ndarjes së mjeteve buxhetore ka marrë një kohë më të gjatë dhe ndarja e projekteve është bërë gjatë muajit korrik dhe muajit shtator 2015. Zotimi i mjeteve nga ky fond është bërë në masën 98.38% dhe shpenzimet 56.31 %. Ky shpenzim i ulët i këtij fondi ka ardhur si rezultat i kapaciteteve të kufizuara të komunave, për të përmbyllur procedurat duke marrë në konsideratë sfidat në kuadër të funksionalizimit të administratave të këtyre komunave, prandaj, kjo ndikuar në uljen e përqindjes deri në 85% të realizimit të buxhetit për investimet kapitale. Aktualisht kemi 34 kontrata të nënshkruara (projekte infrastrukturore në komuna); 5 projekte komunale janë zbatuar tërësisht dhe 5 janë në proces të pranimit teknik. Deri më tani është ekzekutuar 25% e buxhetit (nga kategoria e investimeve kapitale).

Auditimi - MAPL ka themeluar Komitetin e ri të auditimit në përbërje të përfaqësuesve nga shoqëria civile; ndërmarrjet publike si dhe një përfaqësues nga një institucion tjetër. Anëtarët e Komitetit të cilët nuk janë shërbyes civilë, kompensohen sipas rregullave të legjislacionit në fuqi, derisa anëtari i tretë që ka statusin e shërbyesit civil, nuk merr kompensim (që nga janari 2016); Auditimi i brendshëm është duke e zbatuar planin vjetor (çdo vonesë është identifikuar gjatë vitit 2016).

Transferimi i aseteve/pronës- MAPL ka ndërmarrë të gjitha veprimet dhe ka kërkuar zyrtarisht nga MF-ja lidhur me transferimin e pasurive tek komunat. MAPL ka arritur që deri në kohën e publikimit të këtij raporti të pastrojë listën e regjistrimit të pasurisë. Nga vlera totale 7,024,524€, gjithsejtë 6,808,886.69 €, janë transferuar dhe ka mbetur vetëm vlera reale e pasurisë 101,526.14.

Gjithashtu, gjatë vitit 2015, është finalizuar Raporti i zhvlerësimit të pasurisë, ndërsa në vitin 2016 është finalizuar edhe Raporti i tjetërsimit të pasurisë. Është themeluar Komisioni për Inventarizimin e Aseteve (për 2016).

Aktualisht Komisioni është duke punuar dhe raporti pritet të përfundojë nga mesi i tetorit.

Abdyl Ymeri, pyeti lidhur me disa të gjetura të paraqitura në raportin e auditimit për MAPL, mirëpo sipas arsyetimit të ministrit dhe të sekretares së MAPL, këto nuk qëndrojnë. Andaj,

shprehu shqetësimin se cila është e vërteta lidhur me këtë. Përgjigjja për këtë nuk u dha as nga auditorët e jashtëm të ZKA-së, me arsyetimin se raportin e ka hartuar një kompani e jashtme e auditimit.

Kryetari- pasi nuk pati diskutim tjetër në këtë pikë, u vendos me këtë përfundim.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që Raporti i auditimit për Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015, të mos adresohet për seancë plenare. Megjithatë, obligohet MAPL-ja të zbatojë në përpikëri planin e veprimit për adresim të rekomandimeve të dorëzuar paraprakisht në KMFP dhe në ZAK.

6. Shqyrtimi i Raportit të Performancës së Auditorit të Përgjithshëm dhe pasqyrave financiare të audituara për vitin 2015;

Faton Topalli, kryetar- Raporti i Performancës së Auditorit të Përgjithshëm dhe pasqyrave financiare të audituara për vitin 2015, është një pasqyre reale e fushës së menaxhimit financiar dhe kontrollit. Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP), ka pranuar raportin vjetor të performancës së ZAP-it për vitin 2015. Këtij raporti me vonë i janë bashkangjitur edhe PVF të cilat nuk janë audituar me kohë nga auditori i jashtëm, për shkak të vonesave për përzgjedhjen e kompanisë audituese nga Zyra e Prokurimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Për sezonin e auditimit 2015/2016, planifikohen të bëhen 109 auditime. Gjatë auditimeve janë dhënë 1,033 rekomandime, prej tyre 313 për nivelin qendror, 521 për nivel lokal, ndërsa për agjencitë e pavarura 199. Prej tyre ishin implementuar 336, apo 32%, të adresuara pjesërisht 304 sosh, apo 29%, ndërsa të pa adresuara 393 apo 37% e tyre. Dukuri kjo mjaft shqetësuese me rastin e mosadresimit të rekomandimeve nga ana e organizatave buxhetore.

Do të ishte mirë që raportet e ZKA-së të përgatiten në kontekst të performancës së shpenzimit të parasë publike dhe çka është arritur me këtë.

Me këtë hapi diskutimin.

Synavere Rysha, theksoi se ky raport është si rezultat i punës së përbashkët në mes të institucioneve dhe ZKA-së, në kontekst të kontrollit më të mirë të shpenzimit të parasë publike.

Besnik Osmani, paraqiti raportin para KMFP-së lidhur me progresin e arritur të ZKA-së për vitin 2015 si dhe dobësitë. Në këtë raport është paraqitur puna e ZKA-së lidhur me treguesit e performancës, nga tri burime të informatave. Rritje e numrit të raporteve të auditiveve, prej 15 raporteve nga viti i kaluar, rritje e numrit të raporteve të performancës, rritja e komponentës së cilësisë së raporteve, etj. Në raport po ashtu, janë dhënë edhe opinionet e auditorit për PVF-të individuale. Opinioni i Auditimit për PVF-të e ZKA-së janë të pamodifikuara pa ndonjë shkelje materiale.

Kryetari, theksoi se i jemi mirënjohës ZKA-së për punën që është duke bërë, në kontekst të ofrimit të raporteve sa me të qëndrueshme dhe me të sakta për KMFP-në dhe aktorët tjerë. Duke u bërë shpeshherë edhe vetëkritik si zyrë.

Abdyl Ymeri, pyeti lidhur me auditimin e PVF-ve të MAPL-së nga një operator ekonomik i jashtëm. Gjatë diskutimeve paraprake dolën dy të vërteta, ndërsa auditorët e ZKA-së nuk dhanë sqarime lidhure me këtë, cili është opinionin juaj lidhur me këtë?

Besnik Osmani- Ne mendojmë se MAPL-në duhet ta auditojë një operator ekonomik i jashtëm, sepse për 11 vite, unë kam punuar në këtë institucion. Andaj edhe për vitin 2016, ne nuk do ta auditojmë MAPL-në, në mënyrë që ti shmangemi konfliktit të interesit.

Synavere Rysha, përmendi shqetësimin lidhur me mosadresimin e rekomandimeve nga ana e institucioneve të audituara, dhe ngriti çështjen se cilët janë hapat e ZKA-së, në adresimin e këtyre rekomandimeve, ku vetëm një përqindje e vogël e tyre po adresohet.

Përfundim

KMFP-ja, vendosi që Raporti i Performancës së Auditorit të Përgjithshëm për pasqyrat financiare të audituara për vitin 2015, të përkrahet si i tillë dhe të mos adresohet për seancë plenare.

7. Të Ndryshme.

Faton Topalli, kryetar, kërkoi nga anëtarët e Komisionit që ta diskutojnë në këtë pikë, ndarjen e punës sa i përket shqyrtimit të raporteve të auditorit për vitin 2015.

Ai, tha se në takimet e mëhershme kemi vendosur që ta bëjmë ndarjen e raporteve sipas opinionit, pra i kemi ndarë raportet që kanë më shumë të gjetura, por meqenëse tani i kemi edhe dy anëtar të Komisionit që janë kthyer në aktivitetet e rregullta të punës, atëherë do të ishte mirë që ta kemi një ndarje më ndryshe.

Ali Sadriu- Propozoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen tjetër, me ç'rast do ta kemi listën e të gjitha Raporteve që kemi pranuar nga ZKA-ja, stafi ta bëjë klasifikimin në bazë të opinionit, e pastaj të shohim se cilat raporte do ti shqyrtojmë.

Kryetari, tha se këtë listë e kemi marrë nga stafi më herët dhe meqenëse kemi kohë sot, na mbetet vetëm ta plotësojmë se cili anëtar për cilat institucione do të jetë referues.

Anëtarët e Komisionit votuan që kjo ndarje të bëhet sot, kundër ishte vetëm z.Ali Sadriu.

Përfundim

Anëtarët e KMFP-së vendosën që: Ministria e Drejtësisë- referues Faton Topalli, Ministria e Kthimit, Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimet Spitalore- referues Fikrim Domka, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Diasporës- referues Ali Sadriu, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme- referues Bali Muharremaj, Komplexet Memoriale dhe Ministria

e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- referues Hajdar Beqa, Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – referues Naim Fetahu, Ministria e Infrastrukturës dhe Agjencia Kosovare e Pronës- referues Enver Hoti, Ministria e Arsimit dhe Universiteti i Prishtinës- referuese Synavere Rysha, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Komisioni Rregullativ e Prokurimit Publik dhe KQZ-së- referues Abdyl Ymeri.

Raporti vjetor i Auditimit për vitin 2015, u vendos që të diskutohet në KMFP, pas dy jave.

Takimi përfundoi në orën 15:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Faton Topalli